

29.04.2026



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly of Obilić

Në mbështetje të nenit 12, par. 2, shkronja (d), nenit 14 dhe 58 pika h të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 04.06.2008, nenit 6, të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 03.04.2019, si dhe nenit 26, par. 1 dhe 2 dhe nën par. 2.1 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 13.08.2020, Kuvendi i Komunës pas shqyrtimit të rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), dt. 24.04.2026, në mbledhjen e mbajtur më dt. 29.04.2026, mori këtë:

VENDIM

**(Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale për N.P.L
“Kastrioti” Sh. A.)**

1. Miratohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit për nevojat e N.P.L “Kastrioti” Sh. A., me seli në Obiliq.
2. Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim sipas Pikës 1 të këtij vendimi është:
 - 2.1 Numri i parcelës kadastrale: P-72614055-00815-1
 - 2.2 Zona Kadastrale: Obiliq
 - 2.3 Sipërfaqja e përgjithshme e parcelës : 3029m²
 - 2.4 Vendi i quajtur Novi Obiliq me kulturë tokë bujqësore kullosë e klasit të 1 me sipërfaqe prej 2944m² dhe kulturë tokë ndërtimore –shtëpi – ndertësë me sipërfaqe 85m²
3. Parcela jepet në shfrytëzim pa kompensim me qëllim të sigurimit të hapësirës për parkimin dhe mirëmbajtjen e makinerive të rënda të ndërmarrjes, për një periudhë kohore afatgjatë prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh.
4. Procedura e dhënies bëhet e drejtpërdrejtë dhe përjashtohet nga procedurat e rregullta konkurruese, duke u mbështetur në Nenin 26, par. 1, 2 dhe nën par. 2.1 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

5. Autorizohet Kryetari i Komunës që, në emër të Komunës së Obiliqit, të lidhë dhe të nënshkruajë Kontratën për dhënie në shfrytëzim të kësaj prone me përfaqësuesin e autorizuar të NPL "Kastrioti" Sh. A.
6. Ky vendim hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL-së, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të Komunës
- Nënkryetarit të Komunës
- Anëtarëve të KK
- MAPL
- U.D të Kryeshefit të N.P.L NPL "Kastrioti" Sh. A.
- Arkivit

